



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**  
**Kuvendi - Skupština - Assembly**

**Legjislatura VI**  
**Sesioni pranveror**

---

Komisioni për Punë të Jashtme, Diasporë dhe Investime Strategjike  
Mbledhja nr. 8  
Prishtinë, më 26.1.2018, në orën 15:00  
Ndërtesa e Kuvendit, salla S-1

**P r o c e s v e r b a l**

**Në mbledhje morën pjesë:** Vjosa Osmani-Sadriu, Time Kadrijaj, Danush Ademi, Aida Dërguti, Dukagjin Gorani, Doruntinë Maloku-Kastrati dhe Zafir Berisha.

**Munguan:** Visar Ymeri, Elmi Reçica, Evgjeni Thaçi-Dragusha dhe Sergjan Mitroviç.

**Pjesëmarrësit tjerë:** Egnesa Vitia, Denur Paçaku, praktikantë dhe media.

**Nga zyra e komisionit:** Minire Hasani dhe Manush Krasniqi.

**Mbledhjen e kryesoi:** Vjosa Osmani-Sadriu, kryetare e komisionit.

**Rendi i ditës:**

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Raportim i ministrit të Ministrisë së Punëve të Jashtme, z. Behgjet Pacolli;
3. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e mbajtura më 20 dhe 26 dhjetor 2017, si dhe më 15 janar 2018;
4. Miratimi i raportit të punës së komisionit për sesionin vjeshtor 2017;
5. Shqyrtimi i draft-Planit dhe Programit të punës së komisionit për vitin 2018;
6. Të ndryshme.

**1. Miratimi i rendit të ditës**

Kryetarja konstatoi se komisioni miratoi rendin e ditës.

**2. Raportim i ministrit të Ministrisë së Punëve të Jashtme, z. Behgjet Pacolli**

**Vjosa Osmani-Sadriu**, lidhur me raportimin e ministrit të Ministrisë së Punëve të Jashtme, z. Behgjet Pacolli, bëri të ditur se ministri i Jashtëm është ftuar për të raportuar në komision që një kohë të gjatë. Ai është ftuar më 22 nëntor dhe 4 dhjetor 2017, më 9 janar 2018 dhe më 22 janar 2018, për të raportuar më 26 janar 2018, por edhe kësaj radhe nuk i është përgjigjur ftesës së komisionit. Po ashtu, theksoi se përmes një shkrese, e cila iu është shpërndarë

anëtarëve të komisionit, z. Pacolli ka njoftuar se gjatë kësaj kohe kur është ftuar, ka qenë jashtë vendit dhe ka propozuar që të dakordohemi për një datë tjetër për të raportuar. Duke u ndërlidhur me punën e MPJ-së, kryetarja propozoi që komisioni të formojë një grup punues për mbikëqyrjen e zbatimit të ligjit, lidhur me emërimet në shërbimin e jashtëm, me ç'rast më pas tha se do të hulumtoheshin shkeljet e pretenduara, pavarësisht mandateve. Sa i përket raportimit të ministrit të Jashtëm, tha se do të dakordohemi sërish për raportim.

### **3. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e mbajtura më 20 dhe 26 dhjetor 2017, si dhe më 15 janar 2018**

Miratohet procesverbali nga mbledhja e mbajtur më 20 dhjetor 2017, ndërsa procesverbalet nga mbledhjet e mbajtura më 26 dhjetor 2017 dhe 15 janar 2018, mbetet të shqyrtohen në mbledhjen e radhës së komisionit.

### **4. Miratimi i raportit të punës së komisionit për sesionin vjeshtor 2017**

Kryetarja konstatoi se komisioni miratoi raportin e punës së komisionit për sesionin vjeshtor 2017.

### **5. Shqyrtimi i draft-Planit dhe Programit të punës së komisionit për vitin 2018**

**Vjosa Osmani-Sadriu**, lidhur me draft-planin e punës, i cili iu është shpërndarë anëtarëve të komisionit, tha se është një dokument, i cili në vazhdimësi mund të shqyrtohet dhe të plotësohet. Ajo propozoi që draft-plani i punës të plotësohet me këto pika: Raportim i zëvendëskryeministrit, z. Enver Hoxhaj, lidhur me anëtarësimin e Kosovës në Këshillin e Evropës, të parashihet në muajin janar dhe në muajin mars apo prill; Raportim i kryenegociatorit, z. Avni Arifi, lidhur me procesin e dialogut Kosovë-Serbi dhe takim i përbashkët i komisioneve parlamentare, lidhur me procesin e dialogut Kosovë-Serbi.

Pas diskutimeve, kryetarja konstatoi se komisioni nxori këtë:

#### *Përfundim*

*Miratohet Planit dhe Programi i punës së komisionit për vitin 2018, me propozimin e kryetarës së komisionit dhe propozimet, të cilat do t'i parashtrijnë anëtarët e komisionit.*

### **6. Të ndryshme**

**Vjosa Osmani-Sadriu**, vendimin e Kryesisë së Kuvendit për ndërprerjen e udhëtimeve zyrtare jashtë vendit të deputetëve të Kuvendit, deri më datë 20 shkurt 2018, tha se e sheh tërësisht të panevojshëm e në veçanti ndaj këtij komisioni, të cilin e privon nga funksioni i tij themelor në ushtrimin e diplomacisë parlamentare.

**Aida Dërguti**, propozoi që kërkesat për udhëtime zyrtare të shqyrtohen fillimisht në Komisionin për Punë të Jashtme, Diasporë dhe Invesitme Strategjike, ngase do të ishte e dobishme dhe do të lehtësonte punën e Kryesisë së Kuvendit.

**Vjosa Osmani-Sadriu**, theksoi se Komisioni për Punë të Jashtme, në të kaluarën, është marrë me shqyrtimin e kërkesave për vizita zyrtare dhe se këtë çështje, me pëlqimin e anëtarëve të komisionit, tha se mund ta ngrisim në Kryesinë e Kuvendit.

Mbledhja përfundoi në orën 15:20.

E përgatiti:

Njësia për mbështetjen e komisionit.

Kryetarja komisionit,

---

Vjosa Osmani-Sadriu